



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:156477
Datë: 10.01.2024
Numri i dokumentit: 05171116

P.nr.98/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. H. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1814/22 të dt.17.07.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 19.12.2023, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Qazim Xharra dhe i akuzuari M. H., me dt.21.12.2023, shpallë, ndërsa me dt.05.01.2024, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: M. H., nga i ati V. dhe e ëma E. e lindjes D., i lindur më datën ... në Malishevë Rr. „I.“, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 31.05.2022 rreth orës 00:35 minuta në fshatin K. K-Malishevë, pa autorizim ka poseduar narkotik, substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme e në kundërshtim me nenin 9 dhe 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore Nr.02/L-128, dhe atë narkotikun e llojit marihuanë me peshë 1.09 gram, në atë mënyrë që derisa i pandehuri ishte duke drejtuar veturën e tipit VË pasat me targa ..., është ndaluar nga policia dhe me rastin e kontrollimit të automjetit i'u është gjetur narkotiku i llojit marihuanë i mbështjellur në me letër të aluminit, një pako rizlla dhe një mulli/grinder për bluarjen e marihuanës, të cilat janë sekuestruar nga policia.

- Me këto veprime kryer veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43 69, dhe nenin 296 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej **300 € (treqind) euro**, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e cekur, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh, duke llogarit çdo 20 euro në një ditë burgu.

Në pajtim me nenin 269 par.3 të KP-së i shqiptohet dënimi plotësues ashtu që i konfiskohet: substanca narkotike, e llojit marihuanë, me peshë totale prej 1.09 gram, një pako rizlla dhe një mulli (grinder) për bluarjen e marihuanës.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 20 € (njëzet) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 20 € (njëzet) euro, ndërsa shpenzime te procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1814/22 të dt. 17.07.2023, e ka akuzuar të akuzuarin M. H., për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 19.12.2023, ku prezent kanë qenë, prokurori i shtetit Qazim Xharra si dhe i akuzuari M. H., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari M. H. në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprat penale për të cilat ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilin jam penduar, por ne veturë dikush nga shokët e kishte lënë, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin andaj kërkoj nga gjykata që të merren të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqyrtimit të dënimit, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: Duke e pasur parasysh se i akuzuari e pranoi fajësinë si në dispozitiv të aktakuzës paraprakisht duke parë natyrën, pasojat dhe favoret e pranimit të fajit, pranimi i

fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, po ashtu faktit se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes, respektivisht provave materiale dhe personale që

përmban aktakuza e në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitivin të aktakuzës, me çka edhe përmbushen edhe elementet qenësore të veprës penale nga neni 269 par.2 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe po ashtu faktet se aktakuza është e ligjshme dhe provat të cilat i përmban janë prova të nxjerra nga provat e përgjithshme. Propozojmë gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet një dënim i paraparë me ligj duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë në këtë shqyrtim ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh faktin se i pandehuri ka pasur shkallën e lartë të dashjes, po ashtu në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së, të konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis në peshë prej 1.09 gram.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari M. H. me dashje ka kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i oficerit A. S., dt.31.05.2022;
- Raporti i ekspertimit me numër ..., dt.01.11.2022, i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, dt.31.05.2022;
- Deklarata e të pandehurit M. H., e dhënë në polici me dt.31.05.2022;

- Fotot albumi nga njësia e forenzikës, dt.31.05.2022
- Si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 269 par.2 të KPRK-së, është parashikuare se: „ Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, ndërsa në par.1 parashihet „ Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”

5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M. H. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, është i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej 300 euro (treqind) të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7 Konfiskimi

Konform nenit 269 par.3 të KP-së i konfiskohet: substanca narkotike, e llojit marihuanë, me peshë totale prej 1.09 gram, një pako rizlla dhe një mulli (grinder) për bluarjen e marihuanës.

8 Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të

viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.98/23, me dt.21.12.2023.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.